

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Qershor, 2016

SBASHK-u ka vazhduar me traditën e mirë
Në bregdetin shqiptar 410 pushues nga e tërë Kosova



Komisioni 12 anëtarësh kishte bërë me kohë gjithë përgatitjet për të organizuar në nivel sa më të lartë pushimet për 410 anëtarë të SBASHK -ut nga e tërë Kosova. E hëna e 20 qershorit ishte e veçantë. Tetë autobusë janë nisur nga 7 qendra dhe nga UP -ja. Për mirëvajtjen janë kujdesur kryetari i komisionit Ymer Ymeri bashkë me Kadri Thaçin, Nezafete Jakupin, Arta Lamën, Sanie Vocën, Zejnije Doganin, Esengyl Dinovcin, Avdulla Krasniqin, ... (faqe 5)

Konferenca e matematikës në nivel vendi

Lidhshmëri e madhe mes matematikës dhe lëndëve tjera



Angazhimet e shumta të SBASHK-ut janë duke u vlerësuar lartë nga anëtarësia... (faqe 6)

Në përpjekje që çështjet të zgjidhen me dialog

SBASHK-u takohet me Zv/Kryeministrin e Kosovës, z. Kujtim Shala

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i shoqëruar nga përgjegjësi për financa dhe administratë, Ymer Ymeri(faqe 7-8)

Intervistë me kryetarin e SUSHK-ut, z. Bardh Bardhi

Bardhi i gëzohet arritjeve në SBASHK

Bardh Bardhi është kryetar i SUSHK dhe anëtar i kryesisë së SBASHK-ut. Punon me përkushtim. Është shok i mirë dhe është i drejtpërdrejtë ... (faqe 3)

SBASHK-u po përfundon me sukses një aktivitet të rëndësishëm

Janë forcuar kapacitetet njerëzore për dialogun social



Me mësimdhënës nga Kaçaniku, Hani i Elezit, Shtërpca, Shtëmja, Dragashi e Juniku ... (faqe 7)

Editorial

I ndershmi të nderon



Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/90 – 1998/99. Çështja e pazgjidhur ende e udhëtimit dhe e tri pagave janë tema diskutimi me përfaqësuesit e Qeverisë e të Parlamentit. Po ashtu tema diskutimi janë edhe përpjekja për unifikimin e pagës dhe pjesës stimulative, 0.5 % për pjesën stimulative në emër të viteve të shërbimit për administratën e UP-së dhe Kontrata Kolektive në Universitet.

SBASHK-u vazhdon me angazhimet dhe nuk po ndalet as tani kur mësimi në shkolla ka përfunduar. Po angazhohemi për të gjetur zgjidhje për të gjitha çështjet dhe përfaqësues të Qeverisë dhe Parlamentit po na kuptojnë dhe po shprehin gatishmërinë për angazhime të përbashkëta. Po angazhohemi e do të vazhdojmë me angazhimet në shenjë respekti për pjesën më të madhe të punëtorëve të arsimit sepse kanë zemër të madhe dhe janë të qetë e të ndershëm e të përkushtuar.

Pjesa më e madhe e punëtorëve të arsimit kanë zemër të madhe dhe janë të qetë e të ndershëm. I ndershim të nderon, thotë populli. Kjo hetohet gjatë takimeve me shumicën e punëtorëve të arsimit. Ata dinë të çmojnë angazhimet dhe janë falënderues. Kjo zemër e madhe e tyre dhe sinjeriteti e ndershmëria të japin forcë shtesë dhe të obligojnë që të vazhdojnë me angazhimet e me takimet me zyrtarët më të lartë të vendit e të subjekteve politike në Parlament për të gjetur bashkë rrugën më të lehtë për realizimin e kërkesave. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 , Projektligji mbi Statutin e Mësimdhënësve shqiptarë të

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervistë me kryetarin e SUSHK-ut, z.Bardh Bardhi

Bardhi i gëzohet arritjeve në SBASHK



Bardh Bardhi është kryetar i SUSHK dhe anëtar i kryesisë së SBASHK-ut. Punon me përkushtim. Është shok i mirë dhe është i drejtpërdrejtë . “jam i drejtpërdrejtë,bashkëpunues ,nganjëherë ma i rreptë së sa duhet të isha, por nuk veprojë pas shpine”, e thotë Bardhi. Bardhi vazhdon me tërë

forcën e duke gëzuar përkrahjen e SBASHK-ut dhe SUSHK-ut të realizojë kërkesat e anëtarësisë në UP dhe të Institucioneve tjera të Arsimit të Lartë. Pjesa më e bukur e planetit për bardhin është Rugova e në veçanti fshati Bogë. Ai pranoi me kënaqësi të përgjigjet në pyetjet për këtë intervistë dhe ne i jemi mirënjohës.

Arsimimi Sot:

1.Kush është Bardh Bardhi?

Bardhi:

Bardh Bardhi,ka lindur me 13.08.1957,në Stankaj të Rugovës,Pejë

Shkollën n fillore e ka kryer Bogë dhe Trestenik të Pejës.

Shkollën e mesme e ka kryer në Gjimnazin “11Maji” tash “Bedri Pejani”në Pejë.

Fakultetin e ka kryer në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë në vitin 1981/82

Shkallen e tretë-magjistraturën e ka regjistruar në vitin 1985/86 semestrin e parë-dytë,vitin 1986/87 semestrin e tretë-katërtë, si gjeneratë e pare në Universitetin e Kosovës,(por për shkaqe objektive nuk e ka përfunduar)

Punësohet në “Agrokosova –Commerce” në vitin 1981/82 si praktikantë dhe pastaj deri në vitin 1991-janar kur largohet nga puna si Udhëheqës i departamentit të Export-Importit .Pastaj vazhdon të punojë në Biznes privat si bashkëpronar dhe Menaxher i export-importit në firmën”Edi-Impex”me seli në Mitrovicë deri në vitin 1996.

Prej vitit 1996/97 fillon punën në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë si Menaxher –Udhëheqës i kontabilitetit dhe financave

ku edhe tani është i punësuar- duke punuar me kohë të pacaktuar.

Bardhi,është i martuar ka gruan dhe dy vajza,Gruaja ka të kryer Fakultetin Ekonomik,dhe punon. Vajzat kanë të kryer Fakultetin dhe Master në Fakultetet gjegjëse: njëra ekonomik-menaxhment, tjetra sundim të ligjit – juridik dhe punojnë të dyja .

Jeton dhe vepron në Prishtinë që nga viti 1976 .

Arsimimi sot :

2.Fillimet tuaja ne SBASHK? Si e shihni SBASHK-un sot. Angazhimi juaj si kryetar I SUSHK-ut?

Bardhi:

Në SBASHK ka filluar së pari si aktivist pas kthimit nga lufta në vitin 1999 duke marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmës së dhenë nga SBASHK prej 100 DM. çdo të punësuar në UP. si dhe në shpërndarjen e nga një(1) Kompjuteri për secilën Shoqatë Sindikal të njësive akademike të UP-së.

Pastaj në vitin 2000 u zgjedha Kryetari i SH.S të Fakultetit dhe në vazhdim në dy mandate. Në vitin 2010 në Kuvendin e SUSHK-ut u zgjedha anëtar Kryesisë dhe menaxher i financave.

Ne vitin 2012 në Kuvendin zgjedhor të SUSHK-ut u zgjedha Kryetar dhe njëherësh me automatizëm jam edhe Anëtar i Kryesisë së SBASHK-ut,,pozitë të cilën e mbaj deri në zgjedhjet e ardhshme.

Arsimimi sot :

3.Si e shihni SBASHK-un sot. Angazhimi juaj si kryetar i SUSHK-ut?

Bardhi:

SBASHK-un e shohë sot si një federatë Sindikale shumë të fortë dhe shumë aktive duke iu falënderuar punës së kryetarit të ri dhe kryesisë ka ardhur deri te shtimi në numër i anëtarësisë (ka mbi 21.000)si dhe ne veprimet tjera. Do të kujtoja ato nga më të rëndësishmet Angazhimi për shtimin e mirëqenies për të punësuarit ne Arsimin Parauniversitar dhe atë Universitar duke filluar nga pagesa e 05% për çdo vit të përvojës së punës, shkuarja ne pushime verore për një numër të madh të të punësuarve në arsim, dhënia me rastin e pensionimit nga një orë dorë dhe

mirënjohje si dhe me rastin e pensionimit edhe të tri pagave.

Angazhimi imë në SUSHK-SBASHK është bukur i madh, kur dihet se në vitin 2010 kishim shumë pak anëtar që kontribuonin me kuotizim dhe me angazhimin tonë, pra edhe timin, maksimal arritëm të shtojmë numrin e të anëtarësuarve si dhe në formimin e Shoqatave të reja Sindikale. Sot në SUSHK kemi mbi 600 anëtarë si dhe 14 SH.S. Kemi të anëtarësuar përveç në UP edhe nga Universitetet tjera Publike dhe atë: Mitrovica, Prizreni, Ferizaj dhe jemi në biseda edhe me Universitetet tjera Publike dhe Private që shtrijmë veprimtarin e SUSHK-SBASHK-ut edhe aty ku nuk jemi.

Angazhimi i SUSHK-ut dhe imi në krye të SUSHK-ut është konkret dhe atë

-Shkrija e shtesës-stimulimit në pagën bazë për punëtorët e Administratës së UP-së

-Harmonizimi-Nivelizimi i pagave me Administratën e AQ dhe Rektoratit me Administratën e njësive Akademike-Fakulteteve

-Nënshkrimi i Kontratës Kolektive në mes të SUSHK dhe KD-se(Këshilli drejtues) të UP-së

-Dhënia e 0.5% në Shtesë-stimulim për përvojën e punës deri sa të bëhet shkrija e stimulimit-shtesës.

Arsimimi sot:

4.Jeni i respektuar nga te gjithë në SBASHK, si e keni arritur këtë?

Bardhi:

Për këtë pyetje ma mirë flasin koleget e Kryesisë dhe bashkëpunëtorët e mi, por dua të ceku dy- tri gjera; së pari mundohem maksimalisht të kryej të gjitha obligimet e marra dhe zotimet e dhëna, ti respektoj organet legjitime, te respektoj hierarkinë, rendin dhe ligjin. Institucionet duhet respektuar unë për veten time jam i edukuar në këtë frymë pra jam Institucionanist., jam i drejtpërdrejtë, bashkëpunues, nganjëherë ma i rreptë së sa duhet të isha, por nuk veprojmë pas shpine. Pra me punë dhe mirëkuptim – bashkëpunim arrihen të gjitha. Respekti a mos respekti varët nga vetë ne.

Arsimimi sot:

5.Cilat arritje të SBASHK-ut do t'i veçoni dhe çka tutje?

Bardhi:

Suksese të SBASHK-ut janë të shumta por do ti veçoja disa më kryesoret;

-Nënshkrimi i Kontratës Kolektive me 11.04.2014 MASHT-SBASHK

-Ligji për përvojën e punës 1989/1999

-Draftëligji për kompensimin e kontributit – benenifiteve gjatë viteve 1990/99

ku pjesë e këtij komisioni nga ana e SBASHK-ut kam qenë edhe unë,

-Ligji për pensionet kontributdhënëse për të cilin SBASHK-u ka dhënë

kontribut të madh –

Bashkëpunimi me KEC-in, Seminare të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit

-Bashkëpunimi me GIZ-in, Seminare të ndryshme brenda dhe jashtë vendit

-Dhënia e Kartelave-Kartës Sindikale për të gjithë Anëtarët e SBASHK-ut

-Nënshkrimi i mbi 150 Marrëveshjeve me bizneset e ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku secili anëtar që posedon kartelën sindikale ka lirim prej 10-20%

-Shkuarja në pushime veror në det për anëtarët e SBASHK-ut

-Dhënia e mirënjohjeve dhe nga një orë dorë çdo vit me rastin e pensionimit

Arsimimi sot:

6.Porositë juaj për anëtarët e SBASHK-ut?

Bardhi:

Porositë ime për anëtarët e SBASHK-ut është të punojmë me ndërgjegje të plotë për të mirën tone dhe të fëmijëve tanë, të angazhohemi ma shumë në zbatimin e Statutit të SBASHK-ut dhe të Ligjit mbi organizimin Sindikal. Po ashtu kam një porosi që njohuritë dhe përvojat e marra nga Seminarët, Konferencat e ndryshme që organizohen nga SBASHK ne bashkëpunim me organizatat e cekura me lartë ti përmiehim të Anëtarësia e gjerë neper Shoqatat Sindikale ku punojmë dhe veprojmë

Gjatë muajit

SBASHK-u ka vazhduar me traditën e mirë

Në bregdetin shqiptar 410 pushues nga e tërë Kosova

Komisioni 12 anëtarësh kishte bërë me kohë gjithë përgatitjet për të organizuar në nivel sa më të lartë pushimet për 410 anëtarë të SBASHK-ut nga e tërë Kosova. E hëna e 20 qershorit ishte e veçantë. Tetë autobusë janë nisur nga 7 qendra dhe nga UP-ja. Për mirëvajtjen janë kujdesur kryetari i komisionit Ymer Ymeri bashkë me Kadri Thaçin, Nezafete Jakupin,



Arta Lamën, Sanie Vocën, Zejniye Doganin, Esengyl Dinovcin, Avdulla Krasniqin, Blendor Shatrin, Avdulla Bujupin dhe Sokol Fejzullahun.

Nuk ishte e lehtë puna e komisionit dhe në ditën e parë të pushimit kishte edhe halle, që me urtësi tejkaloheshin. Të 410 pushuesit u ambientuan shpejtë dhe nuk kishte të ndalur kënga dhe bashkëbiseda mes kolegëve. Ata flisnin për angazhimet, sfidat, përpjekjet për ngritjen e cilësisë në arsim dhe nuk kishin si t'i iknin kujtimeve nga kohët e shkuara. Kujtonin edhe studimet, por me gjatë ndaleshin të vitet e 90-ta. Gjithë ky lum njerëzish i ngjante një familje të madhe. Ata shoqëroheshin me valët e detit gjatë gjithë ditës e në mbrëmje ia thoshin këngës bashkë me këngëtarët, që po plotësonin dëshirat e tyre e po lexonin zëshëm përshëndetjet nga njëra komunë te tjetra.



Ajo që binte lehtë në sy ishte moshja e shumicës së këtyre pushuesve. Shumë nga ta ishin afër moshës së pensionit. Kolegët e shkollave të tyre i kishin dërguar

ata për të shprehur kështu mirënjohjen për punën me dekada në arsimimin e brezave. Shumica nga këta njerëz ishin modest dhe falënderues. Ata përgëzonin SBASHK-un dhe komisionin për angazhimin dhe, si në humor, e thoshin kërkesën që pushimi të vazhdojë edhe për se paku një ditë.



Për të ruajtur kujtimet nga këto ditë pushimi anëtarët e komisionit kanë u kanë mundësuar shumë prej pushuesve që të shkruajnë përshtypjet e tyre. Këto fletore do të ruhen me kujdes në SBASHK bashkë me fletoret e përshtypjeve nga vitet e kaluara. Në numrin e radhës së gazetës sonë do të botojmë një pjesë të tyre. Në to është thënë e është shprehur ajo që pushuesit e kanë ndier në shpirt. Ka shuam e shumë falënderime e lëvdata. Ka edhe ndonjë këshillë që ka vlerë dhe do ta ruajmë e do ta vëmë në jetë vitin e ardhshëm me dëshirën e madhe që gjërat të jenë edhe më bukur në të ardhmen.



Të gjithë të punësuarve në arsimin e Kosovës ju dëshirojmë momente të bukura, shëndet të mirë dhe u themi të gëzuar e të lumtur u takofshi me nxënësit e shkollën në shtator.

Konferenca e matematikës në nivel vendi

Lidhshmëri e madhe mes matematikës dhe lëndëve tjera

Angazhimet e shumta të SBASHK-ut janë duke u vlerësuar lartë nga anëtarësia, por edhe nga



institucionet, shoqatat dhe shoqëria civile. Nuk është zhvilluar as edhe një aktivitet i lidhur me arsimin e të mos jetë ftuar SBASHK-u për të marrë pjesë e për të dhënë kontributin për mirëvajtjen e aktivitetit. Është për t'u lavdëruar edhe bashkëpunimi i SBASHK-ut me GIZ-in. Të dy palët janë duke dëshmuar se po bëjnë përpjekje të singerta për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsim. Në shërbim të këtij objekti janë zhvilluar takime me mësimdhënës në të gjitha komunat e Kosovës me temat kyçe për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për rolin e mësimdhënësve për përpilimin e planit zhvillimor të shkollës. Një aktivitet i suksesshëm u zhvillua falë këtij bashkëpunimi në



Gjakovë. Atje është mbajtur Konferenca e Matematikës në nivel vendi me temën kyçe "Korelacioni mes matematikës dhe fushave tjera kurrikulare". Duke hapur punimet e këtij aktiviteti të rëndësishëm arsimor, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj para pjesëmarrësve është shprehur se SBASHK-u është duke zhvilluar angazhime të përditshme në përpjekje që kërkesat e anëtarësisë të realizohen përmes dialogut. Ai ka kujtuar se në

bashkëpunim me GIZ janë duke zhvilluar aktivitete edhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim



duke cekur si shembull të mirë edhe këtë aktivitet me mësimdhënës të matematikës dhe lëndëve nga e tërë Kosova. Përfaqësuesja e GIZ-it, Rrezarta Zhinipotoku-Behluli ka bërë para pjesëmarrësve një prezantim të angazhimit të GIZ-it në disa prej komunave të



Kosovës për të parë gjendjen në arsimin atje dhe për të parë hapa konkret në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsim. Ajo ka lavdëruar bashkëpunimin e frytshëm me SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe cilësisë. Eksperti për arsim dhe Këshilltar i jashtëm i MASHT, z. Osman Buleshkaj ka lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut dhe ka treguar për rëndësinë e kësaj Konference e cila me prezantimet e



ekspertëve do të hap mundësi për bashkëbisedë lidhur

me ndërlidhjen e lëndës së matematikës me lëndët tjera kurrikulare. Ligjëruesit Osman Buleshkaj ,Kastriot Buza, Pleurat Rudi dhe Arlinda Beka janë ndalur te korrelacioni i fushës "Jeta dhe Puna" ,

Shkencat e Natyrës, Fushat tjera kurrikulare me fushën e Matematikës.. Të 110 pjesëmarrësit janë shprehur se ky ishte një aktivitet me vlerë dhe kanë kërkuar që aktivitete të tilla të organizohen edhe në ta ardhmen.

SBASHK-u po përfundon me sukses një aktivitet të rëndësishëm **Janë forcuar kapacitetet njerëzore për dialogun social**

Me mësimdhënës nga Kaçaniku, Hani i Elezit, Shtërpca, Shtimja, Dragashi e Juniku po shënohet përmbyllja e ciklit të trajnimeve për dialogun social. Në këtë trajnim për dy vjet me radhë janë përfshirë anëtarë të SBASHK-ut nga gjithë komunat e Kosovës. Qëllimi i trajnimit ishte që të forcohen kapacitetet për udhëheqjen efektive të dialogut social. Bashkë me pjesëmarrësit në këto trajnime ka qenë vazhdimisht edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili me pjesëmarrësit ka bashkëbiseduar për angazhimet e SBASHK-ut në realizimin e kërkesave dhe për sfidat nëpër të cilat po kalohet.



Ai vazhdimisht ka përsëritur se gjithë arritjet janë rezultat i besimit dhe unitetit të fuqishëm në SBASHK. Kontribut për arritjen e e plotë objektivave të këtij trajnimi kanë dhënë trajnerët Ymer Ymeri,

Vjollca Shala e Safet Beqiri, që aty e këtu janë ndihmuar edhe nga kryetari Jasharaj.

"Përkufizimi i dialogut social", "Sfidat që shfaqen në dialogun social", "dialogu social në nivelin kombëtar" ishin disa nga temat që trajnerët Ymer Ymeri kanë shpalosur gjatë rrjedhës së trajnimit.



Trajneri Ymer Ymeri dhe kolegët e tij aktivitetin e kthenin në bashkëbisedë me pjesëmarrësit për çështjet e lidhura me dialogun social dhe kjo i jepte rrjedhë të mbarë punimeve të trajnimeve . Pjesë e veçantë e këtij aktiviteti ishte puna në grupe, që të ndarë në sindikalistët në një anë dhe në përfaqësuesit e shtetit në anën tjetër, krijonin atmosferë "të nxehtë".

Ky trajnim është i licencuar dhe pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata të nënshkruara nga trajnerët dhe autoritetet e SBASHK e MASHT.

Në përpjekje që çështjet të zgjidhen me dialog

SBASHK-u takohet me Zv/Kryeministrin e Kosovës, z. Kujtim Shala

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i shoqëruar nga përgjegjësi për financa dhe administratë, Ymer Ymeri janë takuar me Zv/Kryeministrin e Kosovës dhe Ministër i Kulturës, z. Kujtim Shala. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë njoftuar Zv/Kryeministrin Shala për angazhimet dhe për aktualitetin në arsimin e Kosovës duke shtruar çështje

konkrete e duke kërkuar mbështetjen e tij këto kërkesa të zgjidhen përmes dialogut. Çështja e parë e ngritur nga SBASHK-u është ajo lidhur me Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-212 , Neni 25 e që ka të bëjë me ndryshimet në nenin 67 të Ligjit ekzistues, pika 2 , jep mundësinë që mësimdhënësit e nivelit të parë, që nisin

vitin shkollor , ta vazhdojnë punën deri në mbyllje të vitit mësimor. SBASHK-u kërkon që kjo të vlejë për



gjithë të punësuarit në Arsimin Parauniversitar duke dhënë argumente të shumta për arsyen e një kërkesë të tillë.

Ata në vazhdim të takimit kanë kërkuar përkrahjen e zv/Kryeministrit e Ministrit të Kulturës edhe për të incizuar angazhimet e Ministrive dhe Qeverisë lidhur me Projektligjin mbi Statutin e Mësimdhënësve shqiptarë të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/90 – 1998/99. Delegacioni i SBASHK-ut ka kujtuar zv/Kryeministrin Shala, se nisma për këtë Projektligj është marrë nga përbërja e kaluar e parlamentit të Kosovës në seancat e 6 dhe 18 prillit 2013 pasi ishin mbledhur 12 mijë nënshkrime të të punësuarve në arsim. Parlamenti ka obliguar MASHT-in për të përgatitur një Projektligj për këtë çështje.

“Ju lusim të angazhoheni që të rihapet bashkëbiseda për këtë projektligj. SBASHK-u është i gatshëm të ulet në tavolinë dhe të zhvilloj një dialog shumë të sinqertë në mënyrë që Projektligji të finalizohet dhe të nisët drejt Parlamentit për procedurat dhe për aprovim”, i janë drejtuar zv/Kryeministri Shala delegacioni i SBASHK-ut.



Ky delegacion ka biseduar me Zv/Kryeministrin dhe Ministrin e Kulturës, z. Shala edhe për nismën që të ngrihen komisione të përbashkëta për të përgatitur tekstin për Kontratën Kolektive për sektorin e kulturës.

Zv/ Kryeministri dhe Ministri i Kulturës, z. Kujtim Shala është shprehur se do të bëj gjithë angazhimet për të parë se si e sa mund të realizohen këto kërkesa të SBASHK-ut

Takim me Kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Ismet Beqiri

Përkrahje për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë

Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 , Projektligji mbi Statutin e Mësimdhënësve shqiptarë të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/90 – 1998/99 ishin çështje që janë shtruar nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe përgjegjësi për financa e administratë, Ymer Ymeri në takimin me kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Ismet Beqiri.

. Në një atmosferë korrekte e të punës , Kryetari i Grupit parlamentar të LDK-së, z. Ismet Beqiri ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe korrektësinë në qasjen ndaj problemeve aktuale . Pas kësaj delegacioni i SBASHK-ut ka kërkuar nga z. Beqiri mbështetje në realizimin e dy kërkesave

konkrete , që lidhen me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punës nr. 03/L-212, konkretisht të nenit 25 e që ka të bëjë me nenin 67 të ligjit aktual. Jasharaj e Ymeri kanë treguar se mësimdhënësit e kanë pritur shumë mirë informatën se në Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-212 , Neni 25 e që ka të bëjë me ndryshimet në nenin 67 të Ligjit ekzistues, jep mundësinë që mësimdhënësit e nivelit të parë, që nisin vitin shkollor , ta vazhdojnë punën deri në mbyllje të vitit mësimor. Mësimdhënësit në takimet me kryesinë e SBASHK-ut duke përkrahur këtë nen, shprehen se do të ishte mirë që kjo të vlejë për gjithë Arsimin Parauniversitar.



"Po u vendos me ligj që të gjithë mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar që kanë nisur vitin shkollor, të vazhdojnë me punën edhe pas datës së daljes në pension, do të krijohej edhe një mundësi e shkëlqyer për zgjidhjen e problemit lidhur me tri pagat që duhet dhënë atyre me rastin e pensionimit. Kjo ngase ata do të punonin deri me 30 qershor dhe do të kryenin gjithë obligimet me mbyllje notash, me plotësimin e librezave apo dëftesave, me plotësimin e ditarëve dhe amzave. Në dy muajt e verës, deri në shtator, ata do të merrnin dy paga që do të konsideroheshin si paga pas pensionimit. Kështu do të plotësohej në masë të madhe edhe kjo kërkesa e tri pagave, që është pjesë Kontratës Kolektive për Arsimin Parauniversitar, e që shtrohet vazhdimisht nga mësimdhënësit dhe SBASHK-u", ka deklaruar delegacioni i SBASHK. Ata pas kësaj kanë kërkuar mbështetjen e z. Beqiri dhe Grupit Parlamentar të LDK-së edhe lidhur me Projektligjin për Statutin e Mësimdhënësve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/99.

"Po ashtu ju lusim për angazhimin tuaj edhe përkitazi me Projektligjin për Statutin e Mësimdhënësve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës për vitet shkollore 1989/99.

Ju kujtojmë se nisma për këtë Projektligj është marrë nga përbërja e kaluar e Parlamentit të Kosovës në seancat e 6 dhe 18 prillit 2013 pasi ishin mbledhur 12 mijë nënshkrime të të punësuarve në arsim. Gjatë vitit

2014 është punuar nga komisionet e SBASHK-ut dhe MASHT-it ky Projektligj dhe në vitin 2015 Ministri Bajrami e ka përgatitur me gjithë elementet e duhura dhe e ka dërguar në Qeveri. Nuk kemi përgjigje deri tani nga Qeveria pse nuk ka shkuar tutje kjo çështje.



JU lusim të angazhoheni që të rihapet bashkëbiseda për këtë projektligj. SBASHK-u është i gatshëm të ulet në tavolinë dhe të zhvilloj një dialog shumë të sinqertë. Të shohim bashkërisht me Ministrinë se cili është fati momental i këtij projektligji.

SBASHK-u

është i gatshëm për dialog dhe për kompromis duke parë nga afër e sinqerisht se cila është mundësia e Qeverisë dhe çfarë e sa mund të bëhet në mënyrë që Projektligji të finalizohet dhe të niset drejt Parlamentit për procedurat dhe për aprovim", ka thënë delegacioni i SBASHK-ut duke kërkuar përkrahjen e z. Beqiri dhe Grupit Parlamentar të LDK-së edhe për këtë çështje me rëndësi.

Kryetari i Grupit parlamentar të LDK-së, z. Ismet Beqiri është shprehur se ai dhe Grupi Parlamentar i LDK-së do të përkrah këto dhe gjithë kërkesat e arsyeshme të SBASHK-ut.

Rektori i UP-së Prof. Dr. Marjan Dema u takua me SBASHK-un

Greva mund të riaktivizohet



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe anëtari i kryesisë së SBASHK-ut dhe kryetar i SUSHK-ut, Bardh Bardhi janë pritur në ambientet e Rektoratit të UP-së nga rektori Prof. Dr. Marjan Dema.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe anëtari i kryesisë së SBASHK-ut dhe kryetar i SUSHK-ut,

Bardh Bardhi kanë prezantuar edhe një herë në bisedë me Rektorin kërkesat e sindikalistëve të UP-së. Ata kanë kujtuar Rektorin Dema se ka kohë që kishin marrë premtime nga institucionet përgjegjëse të UP-së se do të nënshkruhet Kontrata Kolektive dhe se do të bëhet unifikimi i pagës bazë dhe pjesës stimulative për të punësuarit të administratën e UP-së. Po ashtu ata kanë kujtuar edhe faktin se , edhe përkundër premtimit, ende nuk është dhënë pjesa prej 0.5 % për çdo vit shërbimi në pjesën stimulative

Rektori Dema është shprehur i lumtur që po takon përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe atyre u ka folur për vizionin e tij lidhur me zhvillimin dhe progresin e Universitetit të Prishtinës..

Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë takim kanë përcjellë mendimin e bazës se nëse institucionet e UP-së nuk bëjnë angazhim të shtuar për të realizuar këto kërkesa atëherë punëtorët e administratës do të riaktivizohet greva.